



FORÇA JONË

* * * Viti III • Nr. 20 • Shkurt 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Vizita e ministres së Mbrojtjes së Shqipërisë znj. Mimi Kodheli në FSK

Thellohet bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë

Në ambientet e Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës, më 10 janar 2014, qëndroi për një vizitë zyrtare ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, e cila u prit me nderime të larta nga Toğu i Nderit dhe Orkestra Frymore e FSK-së.



Ministria Kodheli fillimisht është prituri në një takim të veçantë nga ministri Agim Çeku, i cili pasi i uroi mirëseardhje në FSK, vlerësoi lartë punën e saj dhe të delegacionit që ajo kryeson. Më pastaj të dy delegacionet vazhduan takimin në nivel të zojeruar. Përveç ministrit Çeku në takim ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët: Zymer Halimi, Bashkim Jashari, Gëzim Hazrolli dhe Enver Cikaçi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së z.

Shkëlzen Sylaj dhe kolonel Hasan Hoxha, ushtrues i detyrës së drejtorit në Departamentin për Siguri dhe Bashkëpunim. Ndërsa pjesë e delegacionit të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, ishin: Islam Lauka, ambasador i Shqipërisë në Kosovë, Gjergj Teneqexhiu, drejtor i kabinetit, Edlira Prendi, këshilltare për shtyp, Arian Zaimi, këshilltar ushtarak dhe kolonel Fiqri Hoxha, atashe ushtarak. Ministri i FSK-së, Agim Çeku, pasi që i dëshiroi mirëseardhje dhe e uroi ministren Kodheli për detyrën e re, falënderoi atë dhe

Ministrinë e Mbrojtjes për ndihmat që kanë dhënë dhe po japin për FSK-në. Ministri Çeku gjatë takimit e ka njoftuar gjerësisht ministren e Mbrojtjes znj. Kodheli për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, shkollimin, trajnimet, bashkëpunimin, planin e zhvillimit në të ardhmen si dhe për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë. Pas takimit të dy ministrat mbajtën një konferencë të përbashkët me gazetarë. Me këtë rast, ministri i MFSK-së, Agim Çeku, tha se FSK-ja është një tregim i suksesshëm në Kosovë, është institucioni më i

besuar nga qytetarët e Kosovës, është institucioni i afirmuar, profesional, kredibil, i trajtuar si partner nga faktori ndërkombëtar dhe thjeshtë është edhe i pranuar edhe nga ana e NATO-s, si një institucion që ka ngritur të gjitha kapacitetet e veta. "Të gjitha sukseset që kemi arritur, një pjesë të rëndësishme të kontributit ka edhe Shqipëria dhe Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, që na kanë ndihmuar, që ne sot, të deklarojmë që jemi institucioni i suksesshëm", tha ai. Në takim të dy ministrat diskutuan edhe për projekte konkrete në të ardhmen. Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Kodheli, falënderoi ministrin Çeku dhe shtoi se kjo vizitë është një kënaqësi e veçantë për të. "Unë në të njëjtën kohë e informova ministrin Çeku për të gjitha zhvillimet e fundit të Forcave tona të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Nga ana e saj, ministria Kodheli nënvizoi se bashkëpunimi në mes dy vendeve tona do të intensifikohet akoma më tej, dhe oguri më i mirë është mbledhja e përbashkët e dy qeverive. Në fund, ministria Kodheli shtoi se me ministrin Çeku ndamë mendimin e njëjtë për nivelin e

bashkëpunimit që kemi midis FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ne të dy palët do të gjejmë rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit më të lartë. Ne jemi këtu për ta mbështetur këtë proces në mënyrë që me ndihmën e aleatëve tanë strategjikë dhe të SHBA-s, Shqipëria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën dhe FSK-në drejt integritit në NATO dhe Bashkim Evropian. Gjatë qëndrimit në Kosovë, ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, u prit në takime të veçanta edhe nga presidentja e Kosovës, Znj. Atifete Jahjaga, kryetari i Parlamentarit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi dhe kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi. Gjatë takimit u biseduan edhe tema të përgjithshme, si angazhimi i përbashkët me qëllim të intensifikimit të marrëdhënieve të shkëlqyeshme midis dy vendeve. Ministria Kodheli, nga ana e saj, shprehu gatishmërinë e Qeverisë së Shqipërisë për të ndihmuar në përfshirjen e Kosovës në iniciativat rajonale dhe ato ndërkombëtare të sigurisë, si dhe për shkëmbim të përvojave në procesin e integritit të Kosovës në NATO.

Gjeneral Kastrati përcolli trajnimet për Menaxhimin e Emergjencave dhe Operacionet Paqësore



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me zëvendës komandantin e Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrollin, më 29 janar, përrollën nga afër trajnimet e pjesëtarëve të FSK-së në Menaxhimin e Emergjencave dhe Operacionet Paqësore, të cilat po mbahen në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore në Prishtinë.

Trajnimet për Menaxhimin e Emergjencave dhe "Operacione Paqësore", që kanë filluar të mbahen gjatë kësaj jave, janë si rezultat i një bashkëpunimi të mirë që FSK-ja ka me Gardën Kombëtare të IOWA-s (SHBA) dhe me Armatën e Turqisë. Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati fillimisht ka falënderuar ekipet e instruktorëve të Gardës Kombëtare të IOWA-s dhe të Armatës së

Turqisë, për mbështetjen e tyre të vazhdueshme përmes trajnimeve të ndryshme si kolektive ashtu edhe individuale, me qëllim që FSK-ja të jetë e gatshme në aspektin profesional të përballimit me çdo lloj situatë emergjente. Gjeneral Kastrati, nga pjesëmarrësit e trajnimeve, kërkoi që njohuritë e fituara t'i bartin me sukses te njësitet e tyre, për të shtuar: "Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur që më punën, angazhimin dhe seriozitetin e tyre të jenë institucioni më i besueshëm në vend. E gjithë kjo nuk do të kishte ndodhur pa mbështetjen e vazhdueshme të miqve tanë". Ndërsa, udhëheqësit e ekipeve trajnuese falënderuan gjeneral Kastratin për vizitën dhe përkushtimin e tij, për bashkëpunimin e mirë si dhe premtuan realizim të trajnimeve më të avancuara për Forcën e Sigurisë të Kosovës.

Ministri i FSK-së Agim Çeku takoi ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar Ian Cliff

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Agim Çeku, më 28 janar, priti ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Ian Cliff. Ministri Çeku falënderoi ambasadorin për ndihmën e çmuar të Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën dhe në veçanti për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ai e njoftoi ambasadorin

Cliff me zhvillimin e përgjithshëm të FSK-së dhe me punën që po bëhet rreth Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Kosovës. Ndërsa, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, z. Ian Cliff, premtoi se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe ndërmjet dy institucioneve do të thellohen edhe në të ardhmen.



Vlerësime për arritjet e FSK-së gjatë vitit 2013 marrë nga gazeta ditore "Epoka e Re"

Viti 2013 i veçantë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti 2014 pritet të jetë vit kur FSK-ja duhet të shndërrohet në Ushtri të Kosovës. Ky është konstatimi i përbashkët i Qeverisë së Kosovës, opozitës dhe ekspertëve të sigurisë. Udhëheqësit e FSK-së dhe anëtarët e komisionit parlamentar

për mbikëqyrjen e kësaj force e kanë vlerësuar të jashtëzakonshme performancën e FSK-së në vitin 2013. Sipas tyre, kjo forcë është institucioni më kredibil në Republikën e Kosovës. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) edhe

këtë vit ka renditur sukseset e saj në përputhje me misionin që ka pasur. E arritura më e madhe për këtë forcë ka qenë plotësimi i kapaciteteve operationale, të cilat u deklaruan nga Këshilli Veri-Atlantik i NATO-s në muajin kor-

rik. Edhe në vitin 2013 FSK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besueshëm nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Madje kjo forcë përbën institucionin e vetëm që i bashkon pozitën e opozitën. Të gjithë, përfshirë opozitën dhe

njohësit e çështjeve të sigurisë, janë të mendimit se tani ka ardhur koha që kësaj force t'i ndryshohen emri, struktura, misioni dhe të ngarkohet me detyra që kanë të gjitha ushtritë e shteteve demokratike.



Ministri Agim Çeku: Viti 2013, vit i kapaciteteve operationale

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Agim Çeku, duke e vlerësuar arritje të jashtëzakonshme plotësimin e kapaciteteve, ka thënë për "Epokën e re" se tanimë kjo forcë nuk është në mbikëqyrje të KFOR-it, por në raporte partneriteti. "Padyshim se edhe viti 2013 ka qenë vit i suksesshëm për FSK-në, e cila ka arritur një fazë të sukseseve edhe këtë vit. Mendoj se ngjarja e vitit sa i përket FSK-së është deklarimi i kapaciteteve të plota operationale nga ana e NATO-s. Pra, vendimi i NATO-s, që ta vazhdojë mbështetjen e FSK-së, duke e themeluar një trup të ri të quajtur Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, krahas ekipit këshillues të NATO-s që është në ministri", ka thënë Çeku. Të arritur tjetër ai ka përmendur rolin aktiv dhe konstruktiv që kjo forcë po luan në rajon, duke u respektuar gjithnjë e më shumë nga forcat ushtarake të rajonit si partnere e denjë nëpër konferenca dhe ushtrime të ndryshme stërvitore. Sipas Çekut, në të gjitha këto aktivitete FSK-ja është dalluar për të mirë nga forcat e tjera të rajonit. Çeku ka shtuar se FSK-ja po e përfundon rishikimin e vet në kuadër të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe është në fund të përmbylljes së procesit për të definuar të ardhmen e vet si forcë ushtarake në Kosovë. "FSK-ja është në përmbyllje të rishikimit, në përmbyllje të definimit të disa të gjeturave nga ky studim dhe në fillim të vitit 2014 do t'ia rekomandojë Qeverisë dhe Këshillit Nacional të Sigurisë se çfarë misioni duhet të ketë, çfarë emri, çfarë strukture dhe çfarë detyra.

Krejt kjo do të jetë në përputhje me ato detyra që forcat ushtarake i kanë në çdo vend të pavarur dhe demokratik", ka thënë ministri Çeku. Ai ka treguar se edhe këtë vit FSK-ja është dëshmuar se është forcë në të mirë të gjithë qytetarëve të Kosovës, duke i ndihmuar ata në realizimin e shumë projekteve.



Gjeneral Kastri: FSK-ja në shërbim të gjithë qytetarëve

Pothuajse vlerësime të njëjta ka pasur edhe komandanti i kësaj force, gjenerallejtënant Kadri Kastri, i cili ka deklaruar për gazetën se viti 2013 ishte vit i realizimit të objektivave, prioriteteve dhe arritjeve të shumta. "Ky vit është vit i plotësimin të kapaciteteve operationale, të cilat u deklaruan nga Këshilli Veri-Atlantik i (NATO-s) në korrik të këtij viti, me ç'rast edhe formalisht u vlerësua puna dhe angazhimi i pjesëtarëve dhe lidhshimit të FSK-së në ngritjen dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve thelbësore për realizim të misionit. Gjithashtu, edhe gjatë këtij viti prioritet imi ishte ngritja profesionale e pjesëtarëve të FSK-së", ka thënë Kastri, duke shtuar se shumë pjesëtarë kanë kryer dhe po vazhdojnë të kryejnë stërvitje, trajnime dhe shkollime brenda dhe jashtë vendit, nëpër akademitë më prestigjioze të vendeve si SHBA, Turqi, Mbretëri të Bashkuar, Gjermani, Kroaci, Holandë, Maqedoni etj. Ai ka treguar se kjo forcë me përgjegjësi të lartë ka vazhduar t'i kryejë operationet e çnimit, kërkim-shpëtimin, inspektimit të kompanive shtetërore dhe private për rrezikshmëri nga materiet e

rrezikshme, vlerësimit të vazhdueshëm të kërcënimeve të mundshme nëpër komunat e vendit. "FSK-ja ka qëndruar afër qytetarëve, komuniteteve, institucioneve dhe organizatave joqeveritare duke i mbështetur ato me projekte të ndryshme humanitare. Ndërtimi dhe meremetimi i rrugëve, urave, shtëpive, pastrimi dhe thellimi i lumenjve dhe zonave të rrezikshme, përkrahja mjekësore e banorëve nga radhët e komunitetit serb etj. ishin prioritetet tona edhe këtë vit", është shprehur Kastri.

Edhe opozita krenare me FSK-në

Kryetari i këtij komisioni, Ahmet Isufi, ka thënë për "Epokën e re" se FSK-ja është institucioni më kredibil në Kosovë. "FSK-ja ka realizuar objektivat e veta sa iu përket ngritjeve profesionale. Pra, kjo forcë ka treguar performancë të jashtëzakonshme sa i përket opinionit, duke qenë në shërbim të popullit të Kosovës. FSK-ja është institucioni më kredibil në Kosovë dhe me këtë mburremi. E vetnja gjë që ka mbetur pa realizuar është emri i merituar i kësaj force që është Ushtri e Kosovës", ka thënë Isufi, duke shtuar se me krijimin një politike ofensive dhe me një bashkëpunim shumë më energjik me strukturat e NATO-s do ta mundësonte edhe realizimin e këtij objekti.

Edhe deputeti i LDK-së në këtë komision, Anton Çuni, ka thënë se ky institucion është më i vlerësuar edhe nga strukturat ndërkombëtare. "FSK-ja është një ndër institucionet që, sipas të gjitha vlerësimeve të autoriteteve ndërkombëtare, ka marrë nota të larta në përbushjen e misionit

dhe në performancën e saj. Po ashtu, kemi pasur rast që FSK-në ta shohim edhe në veprimet konkrete, kur ka pasur nevojë të zbarkojë jashtë vendit siç ishte rastin në Shqipëri apo dhe brenda Kosovës, sidomos në rastet e kërkim-shpëtimin", ka deklaruar Çuni për "Epokën e re", duke shtuar se edhe sondazhet e organizatave joqeveritare të bëra me qytetarët e kanë nxjerrë FSK-në si institucionin me prestigjin më të lartë në Kosovë. Ai ka vlerësuar se institucionet vendore në bashkëpunim me ato ndërkombëtare duhet ta caktojnë mandatin e ardhshëm të kësaj force. "Kjo varet nga vlerësimi i pranisë ushtarake ndërkombëtare, në këtë rast nga KFOR-i dhe NATO, në bashkëpunim me institucionet e vendit që të japin një mendim se çka të bëhet më tutje me FSK-në. Ne si anëtarë të komisionit jemi në dijeni se është formuar një grup punues për rishikimin strategjik të sigurisë dhe jam i bindur se në vitin 2014 ky grup do të dalë me rezultatet e punës se si e shohin organizimin e gjithë institucioneve të sigurisë", ka deklaruar ai.

Ndërsa deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës që FSK-në nuk e ka shndërruar në Ushtri të Kosovës. "Sikur jo rrallëherë, edhe kësaj radhe doli që FSK-ja jo vetëm se nuk u bë ushtri, por vetë fjala apo termi ushtri u zhdruk nga fjalori i atij që e kishte paralizuar këtë gjë. Pra, vetë ministri që e kishte proklamuar se FSK-ja do të bëhej ushtri, i njëjti e hoqi nga fjalori fjalën ushtri", ka thënë Selimi për "Epokën e re". Sipas tij, është e palogjikshme të flitet për integritet euroatlantike dhe të mos bëhet FSK-ja ushtri e Kosovës. "Le të kujtojmë edhe një herë se është joreale dhe hipokrite të flasim për integritetin në NATO nëse njëkohësisht na mungon institucioni mbi të cilin duhet ta

mbështesim anëtarësimin në NATO. Pra, nuk mund të kërkojmë të marrim pjesë nga barra e NATO-s nëse nuk kemi ushtri", ka thënë ai, duke shtuar se Kosova ka nevojë për ushtrinë e saj ashtu siç i kanë të gjitha shtetet e rajonit. Sipas tij, Ushtria e Kosovës do t'i jepte kuptim edhe vetë shtetit të Kosovës.

Ndërsa, njohësi i çështjeve të sigurisë, Naim Maloku, kritikant se pse FSK-ja nuk është bërë ushtri deri më tani i ka quajtur të paarsyeshme. "FSK-ja i ka arritur objektivat që i ka pasur me ligj. Mirëpo edhe kjo forcë është e kushtëzuar edhe prej vlerësimeve të NATO-s dhe pa marrë miratimin e NATO-s, FSK-ja nuk mund të ngritet në detyra dhe obligime të përgjegjësi të tjera jashtë ligjit që i përcaktohen", ka thënë Maloku. Maloku është shprehur i kënaqur me dinamikën e zhvillimit të FSK-së. Ai ka thënë për gazetën se tash, pas arritjeve të objektivave që kanë qenë të përcaktuara me ligj, duhet t'i hapet rrugë kësaj force që të ngritet në ushtri. "Meqë FSK-ja i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe objektivat që i ka pasur të përcaktuara me ligjin për FSK-në dhe me Kushtetutën e Kosovës, duhet që Ligjin për FSK-në Kuvendi i Kosovës ta ndryshojë dhe duhet t'i jepet objektivat e tjera të cilat do t'i mundësojnë kësaj force të zhvillohet me një dinamikë tjetër dhe me u ngrit në ushtri", ka thënë Maloku.

Grupi për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë më së largu deri në shkurt të vitit 2014 do ta prezantojë studimin lidhur me arkitekturën e sigurisë që i duhet Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij procesi gjithëpërfshirës është edhe rishikimi i FSK-së. Ky grup do t'i rekomandojë Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe Këshillit Nacional të Sigurisë se çfarë misioni, emri apo struktura do të ketë FSK-ja në vitin 2014.

Intervistë e marrë nga gazeta "Sioux City Journal" - SHBA

Koloneli Steve Warnstadt: "Shqiptarët më pro amerikanë se vetë amerikanët"

Koloneli amerikan Steve Warnstadt, ish-ligjdhënësi i Shtetit të Iowas, i cili shërbeu si këshilltar i NATO-s në Forcën e Sigurisë së Kosovës, pas qëndrimit të tij njëvjeçar në Kosovë ka krijuar përshtypjen se populli dhe Qeveria e Kosovës janë jashtëzakonisht pro amerikanë.

"Në sondazhet e parvjetshme të Gallup-it, në mbi 100 vende rreth mbështetjes së politikave amerikane, Kosova ka një vlerësim të aprovimit 88 për qind të këtyre politikave.

Është ky një nivel i mbështetjes që sigurisht duhet të jetë më i lartë se sa në mesin e amerikanëve", thotë Warnstadt dhe nënvizon se "është një gjë e zakonshme të vëzhgosh flamurin amerikan të valojë po aq shpesh sa edhe flamuri i Kosovës".

Ai këtu përmend bulevardin "Bill Clinton", dyqanin "Hillary", rrugën "Bob Dole", rrugën tjetër "George W. Bush", emrat e rrugëve dhe shesheve, Madeline Albright dhe



Wesley Clark etj.

Koloneli Warnstadt më tej shkruan se Garda Kombëtare e Iowa-s dhe FSK-ja e Kosovës janë të lidhura në Programin e Partneritetit Shtetëror të Gardës Kombëtare, një program i hartuar në fund të "Luftës së Ftohtë" për të ndihmuar vendet e Evropës Lindore, gjatë

kalimit në demokraci.

"Partneriteti Iowa-s është i veçantë, sepse ai po ndihmon Kosovën për të ndërtuar profesionalizimin e forcave të saja të sigurisë dhe është i njohur si një nga programet më aktive dhe më të fuqishme të partneriteteve shtetërore".

Koloneli Steve Warnstadt thekson më tej: "Kosova përballet me një numër sfidash ku të ardhurat për kokë banori janë më të ulëta në Evropë; ku vendi ka moshën më të re mesatare dhe një nga shkallët më të larta të papunësisë. Mungesa e perspektivës ka ndikuar që shumë të rinj të largohen duke krijuar mungesën e disa prej talenteve të saj më të mirë".

"Përkundër këtyre vështirësive, shumica e kosovarëve janë optimistë për të ardhmen dhe i shikojnë Shtetet e Bashkuara si një model në përballjen me sfidat e tyre", shkruan ndër të tjera në gazetën "Sioux City Journal", koloneli Steve Warnstadt.

Ministri Agim Çeku takoi ambasadorin e ri të Maqedonisë Ilija Strashevskin

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Agim Çeku, më 16 janar, priti një takim njohës ambasadorin e ri të Republikës së Maqedonisë në Kosovë, z. Ilija Strashevski. Fillimisht ministri Çeku, ambasadorit të Maqedonisë i uroi detyrën e re në Kosovë dhe më pastaj e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe për bashkëpunimin e mirë

në mes dy ministrive; Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë dhe Ministrisë së FSK-së.

Ndërsa, ambasadori i sapo-emëruar i Republikës së Maqedonisë në Kosovë, z. Ilija Strashevski falënderoi ministrinë Çeku për pritjen dhe premtori se do të angazhohet me gjithë kapacitetin që marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe dy institucioneve të thellohen edhe më tej në të ardhmen.



Gjeneralmajor Rahman Rama para studentëve të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti"

Zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rahman Rama, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e përgjithshme shkollore, mbajti një ligjëratë për studentët e Universitetit Publik "Ukshin Hoti" në Prizren, me temën: Sfidat e FSK-së në përmbushjen e kapaciteteve operacionale.

Gjeneralmajor Rahman Rama, njëherësh edhe komandant i Forcave Tokësore, i njoftoi studentët dhe profesorët e këtij universiteti për të arriturat e

përgjithshme të FSK-së, për: misionin, strukturën, shkollimin, bashkëpunimin e përgjithshëm të FSK-së, kapacitetet ekzistuese në kuadër të njërive të FSK-së, si dhe për të ardhmen e saj.

Po ashtu i njoftoi edhe për sfidat nëpër të cilat ka kaluar TMK-ja, shpërbërjen e saj dhe krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ndër të arriturat e përgjithshme të FSK-së, gjeneral Rama tha se ishte përmbushja e kapaciteteve të plota operacionale, të prokla-

muara vitin e kaluar nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, z. Rasmusen.

Në fund, zëvendëskomandanti i FSK-së foli edhe për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë në Kosovë dhe rolin e FSK-së në të ardhmen.

Studentët dhe personeli akademik i universitetit "Ukshin Hoti" shprehën interesim të madh gjatë ligjëratës, duke shtruar një numër të madh pyetjesh që kishin të bënin me të ardhmen e FSK-së.

Komandanti i FSK-së mirënjohje për kolonelin Will Smallwood nga Mbretëria e Bashkuar

Komandanti i FSK-së gjenerallejtnant Kadri Kastrati, ka organizuar një takim ceremonial për kolonelin Will Smallwood nga Mbretëria e Bashkuar, me rastin e përfundimit të punës së tij, si këshilltar i komandantit të FSK-së. Ceremonia u mbajt në ambientet e Ministrisë së FSK-së, ku komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati falënderoi kolonelin Smallwood për angazhimin dhe punën e tij profesionale si dhe për kontributin e dhënë me këshilla dhe trajnime të ndryshme për FSK-në. Me këtë rast gjeneral Kastrati tha: "Koloneli Will Smallwood e ka ndihmuar vazhdimisht FSK-në, ku fokusi kryesor i tij ka qenë trajnimi, mentorimi dhe këshillimi i FSK-së për operacione, trajnime e të tjera.

Më tej gjeneral Kastrati tha se FSK-ja dhe Ai personalisht, e vlerëson lartë punën profesionale dhe angazhimin e kolonelit Smallwood për zhvillimin e FSK-së, në një forcë profesionale dhe kompetente që e pavarur mund të përmbushë detyrat e veta. Më pastaj, komandanti i FSK-së u zotua se ne do të vazhdojmë përpara për të zhvilluar marrëdhëniet tona profesionale me Shtetin e Britanez dhe vazhdimin



e marrëdhënieve të mira që kemi me Britaninë e Madhe, me KFOR-in, dhe ndërtimin e të ardhmes tonë, me Ekipin Këshillues-Ndërlidhës të NATO-s.

Ndërsa këshilltari i komandantit, koloneli Will Smallwood përgëzoi komandantin për të gjitha të arriturat dhe premtori se gjithmonë do të jetë i lidhur me FSK-në. Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, në shenjë falënderimi, kolonelit Will Smallwood i ndau "Mirënjohje" me motivacionin për kontributin e dhënë në zhvillimin e FSK-së.

Kompania e Deminimit e FSK-së vetëdijeson nxënësit për rrezikun nga minat dhe mjetet e pashpërthyer



Nxënësit të pajisen me njohuri rreth rrezikut nga mjetet e pashpërthyer. Ndërsa rreshteri i FSK-së, Afrim Qusaj i vlerësoi lart njohuritë e fëmijëve për sa i përket rrezikut nga minat dhe mjetet e pashpërthyer. Ai tha se tashmë fëmijët janë në gjendje të njohin ngjyrat, format, dhe procedurat se çka duhet ndërmarrë pasi ta shohin një mjet të rrezikshëm. "Shumica e nxënësve falë këtyre ligjëratave janë aftësuar jashtëzakonisht shumë lidhur me mjetet e pashpërthyer, madje ka pas raste kur ata vetë na kanë informuar se kanë hasur në këto mje."

Zëvendësiministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK-së), Muhamet Latifi, më 21 janar 2014 vizitoi nxënësit e shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi" në Llukarë të Prishtinës, gjatë një ligjëratë për rrezikun nga minat dhe mjetet e pashpërthyer, që u mbajt nga pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit të FSK-së. Zëvendësiministri i MFSK-së, Latifi, u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur me vizitën që i bëri nxënësve të kësaj shkolle, njëherësh ai shprehu gatishmërinë e FSK-së për bashkëpunim të mëtejshëm për çdo gjë që është në të mirë të qytetarëve e në këtë rast të fëmijëve. "Kam ardhur këtu tju vizitojë më

shumë dëshirë, në emër të ministrit të FSK-së dhe gjeneralëve tanë, dhe dua tua rikujtoj se këto ligjëratat janë shumë të rëndësishme dhe shprej se do të jenë të efektshme për ju, për tu informuar më gjerësisht për rrezikun nga minat dhe mjetet e pashpërthyer. Këto njohuri që ju po merrni nga FSK-ja duhet tua shpjegoni edhe fëmijëve tjerë dhe gjithë qytetarëve të Kosovës" u shpreh zv. ministri Latifi. Edhe drejtori i shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi", Ilir Krasniqi, bashkëpunimin me FSK-në e cilësoi si shumë të rëndësishëm dhe shpreh mirënjohjen e tij për pjesëtarët e FSK-së, që po ndihmojnë



ligjëratat për vetëdijesim nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyerja i ka filluar që në muajin

dhjetor (sezoni dimëror) dhe po vazhdon t'i mbajë nëpër shkollat fillore e të mesme të Kosovës.



Gjeneral Cikaqi, falënderoi kolonelin WOOD për ndihmën e vazhdueshme të SHBA-së

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneralbrigade Enver Cikaqi priti në një takim pune, komandantin e KFOR-it amerikan në Bonstill, kolonelin David Wood. Gjeneral Cikaqi, me këtë rast, falënderoi kolonelin për ndihmën e vazhdueshme që SHBA-ja dhe KFOR-i amerikan po jep për FSK-në. "Edhe gjatë vitit që lamë pas, Ushtria amerikane, që vepron në Grupin Shumëkombësh Lindja në Bonstill, ka ofruar trajnime të gjithanshme dhe ka mbështetur me të gjitha format Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, përmes programeve dhe personelit



(instruktorëve) për realizimin e shumë trajnimeve, me qëllim të

ngritjes profesionale, dhe për këtë i jam shumë falënderues

Ushtisë amerikane" ka thënë gjeneral Cikaqi. Ndërsa, komandanti i Bonstillit, koloneli Wood, nga ana e tij, garantoi gjeneralin Cikaqi për vazhdimin e ndihmës për KDS-në. Ai tha: "Qëllimi i kësaj vizite të përbashkët është të kemi edhe një takim pune para se të përfundoj mandatin tim, dhe së bashku me ju, gjeneral, të bëjmë një analizë pune për realizimin e detyrave dhe përmeshjes së obligimeve, me qëllim që këtë bashkëpunim ta vazhdoni edhe me komandantin e ri, që do të vijë së shpejti në Kosovë". Koloneli WOOD shprehi falënderimet e tij për

bashkëpunimin dhe sinjeritetin gjatë tërë kohës sa ka qëndruar në detyrën e komandantit të Crupit Shumëkombësh Lindje në Bonstill. Kjo ishte vizita e fundit e kolonelit WOOD si komandant në Bonstill. Në fund, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi falënderoi kolonelin WOOD për angazhimin e tij në KDS, në avancimin e trajnimeve dhe ngritjen profesionale të FSK-së. Të dy komandantët prematuan angazhim maksimal edhe në të ardhmen, me qëllim të forcimit të këtij bashkëpunimi të ndërsjellshëm në mes FSK-së dhe KFOR-it amerikan.

Pjesëtarët e FSK-së trajnohen nga Garda Kombëtare e IOWA-s dhe Ushtria e Turqisë

Në kazermën "Adem Jashari" në Komandën e Forcave Tokësore (KFT), Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka filluar trajnimin për Menaxhimin e Emergjencave dhe Operacione Paqësore nga Garda Kombëtare e IOWA-s (SHBA) dhe nga ekipi i instruktorëve të Qendrës për Trajnime të Ushtrisë në Turqi (PTP-Partnership for Peace Training Center), ku po marrin pjesë 30 pjesëtarë të një-sive të ndryshme të FSK-së. Fillimin e trajnimeve e përcollën nga afër, drejtori i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), gjeneral brigade Imri Ilazi, i cili falënderoi Gardën e IOWA-s dhe Republikën e Turqisë, për ndihmën që po japin për FSK-në. Gjeneral Ilazi, me këtë rast, foli edhe për bashkëpunimin dypalësh të FSK-së për trajnimet, shkollimet dhe bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Republikën e Turqisë. "Pjesëtarët e FSK-së kanë marrë dhe po marrin pjesë në shumë trajnime si në Kosovë edhe jashtë saj, ku nga këto trajnime kanë përfituar përvo-

Kombëtare të IOWA-s, ndërsa trajnimi për Operacione Paqësore është organizuar nga instruktorët e Qendrës për Trajnime të Ushtrisë në Turqi (PTP-Partnership for Peace Training Center), ku po marrin pjesë 30 pjesëtarë të një-sive të ndryshme të FSK-së. Fillimin e trajnimeve e përcollën nga afër, drejtori i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), gjeneral brigade Imri Ilazi, i cili falënderoi Gardën e IOWA-s dhe Republikën e Turqisë, për ndihmën që po japin për FSK-në. Gjeneral Ilazi, me këtë rast, foli edhe për bashkëpunimin dypalësh të FSK-së për trajnimet, shkollimet dhe bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Republikën e Turqisë. "Pjesëtarët e FSK-së kanë marrë dhe po marrin pjesë në shumë trajnime si në Kosovë edhe jashtë saj, ku nga këto trajnime kanë përfituar përvo-



ja në menaxhimin e emergjencave dhe në operacione paqësore", ka shtuar në fund gjeneral Ilazi. Në përcjelljen e ushtrimit të pjesëtarëve të FSK-së për menaxhimin

e emergjencave dhe operacioneve paqësore, morën pjesë edhe shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri dhe shef i

Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, nënkolonel Hasan Hoxha, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK.

Certifikohen 30 pjesëtarë të FSK-së për Operacione Paqësore

Në ambientet e Brigadës për Mbështetje Operacionale (MBO) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), sot u bë certifikimi i 30 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kryen me sukses një trajnim për "Operacione Paqësore", të mbajtur nga Ekipi i Instruktorëve të Qendrës për Trajnime të Republikës së Turqisë. Në ceremoninë e certifikimit morën komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, komandantit i BMO-së, gjeneralbrigade Ilaz Derguti, zëvendës komandantit i KFOR-it gjeneralali Wessely, komandanti i NLAT-it, gjenerali Wagner dhe komandanti i kontingjentit Turk, Koloneli Topaloglu.



Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, fillimisht e falënderoi ekipin e instruktorëve të Turqisë, duke u shprehur mjaft i kënaqur me bashkëpunimin e

mirëfilltë, ndërmjet FSK-së dhe Armatës së Turqisë. Ai, tha se: "Synimi i FSK-së është ngritja profesionale e kapaciteteve sipas standardeve të NATO-s, e në këtë

drejtim një kontribut të madh, në këtë drejtim, po jep Ekipi i Forcave të Armatosura të Turqisë, përmes trajnimeve të shumta, e që janë të një rëndësi të veçantë për FSK-në". Ndërsa, në emër të Qendrës për Trajnime të Republikës së Turqisë, koloneli Turk, Topaloglu premtori se edhe në të ardhmen do ta ndihmojnë FSK-në. Ai përsëriti të gjithë pjesëtarët e FSK-së, për interesimin dhe seriozitetin e tyre që treguan gjatë mbajtjes së këtij trajnimi, që është më rëndësishëm për FSK-në. Në fund, për arritjen e rezultateve dhe kryerjen me sukses të trajnimit për "Operacione Paqësore" të gjithë pjesëtarëve të FSK-së, u dhanë Certifikata.

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, certifikohen 27 pjesëtarë të FSK-së

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, ditë më parë, është mbajtur ceremonia për certifikimin e 27 pjesëtarëve të Kompanisë 2C të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, të cilët për katër muaj kanë kryer një trajnim intensiv (shtator-dhjetor 2013) nga ekipet trajnuese të Ushtrisë së Turqisë. Ky trajnim dhe trajnimet e mëparshme me Batalionin e Parë dhe të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në mes Forcave të Armatosura të Turqisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).



Në ceremoninë e certifikimit përveç stafit komandues të BRSH-së, morën pjesë edhe koloneli Erdal Dodurga (këshilltar

i komandantit të FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati), nënkolonel Metin Yilmaz (shefi i ekipit trajnues turk), nënkolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, në MFSK, nënkolonel Mehmet Lladrovci, komandant i Batalionit të Dytë të BRSH-së dhe ekipi i instruktorëve turq. Komandanti i BRSH-së, gjeneralbrigade Nazmi Brahimaj, fillimisht ka falënderua ekipet e instruktorëve të Turqisë, për kontributin që kanë dhënë në mbajtjen e trajnimeve të tilla, me qëllim të ngritjes dhe profesionalizimit të pjesëtarëve të Brigadës për Reagim të Shpejtë. Ai, nga të certifikuarit

kërkoj që njohuritë e fituara nga trajnimet e deritashme t'i bartin me sukses tek pjesëtarët e tjerë të FSK-së, me qëllim të avancimit të një-sive të tyre. Ndërsa, koloneli Erdal Dodurga foli për rëndësinë e trajnimeve të këtij niveli, për bashkëpunimin e mirë në mes Armatës së Turqisë dhe FSK-së, si dhe për gatishmërinë e tyre që edhe në të ardhmen ta mbështetin FSK-në në të gjitha format e mundshme. Në fund, gjenerali Brahimaj, komandanti i BRSH-së dhe koloneli Erdal Dodurga, ndanë certifikata për pjesëtarët e FSK-së, për përfundimin me sukses të këtij trajnimi intensiv.

Intervistë me rreshtermajor Sheryl Lion, KFOR-i Amerikan, Grupi Shumëkombësh-Lindje

FSK-ja në rrugë të mirë për trajnimin profesional të nënoficerëve



Rreshtermajor Sheryl Lion gjatë muajit shkurt e përfundon misionin në kuadër të KFOR-it amerikan, Grupi Shumëkombësh Lindje në Bonstill. Ajo që nga fillimi i punës së saj këtu, ka dhënë një kontribut të madh në realizimin e shumë trajnimeve profesionale për pjesëtarë të FSK-së, e sidomos dallohet për bashkëpunimin me Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Rreshter major Lion u dallua për angazhimin e saj profesional, për monitorimin dhe përgatitjen e instruktorëve të FSK-së, "Trajno-Trajnerët" dhe "Kursi i Avancuar i Liderit" (KAL) të realizuar së bashku me një ekip ushtarakësh amerikanë. Ekipi amerikan ka punuar ngushtë me ekipin e FSK-së, dhe se bashku kanë arritur që të adoptojnë kursin për pjesëtarët e FSK-së, i cili po zhvillohet në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Instruktorët e FSK-së, të cilët kanë kryer këtë kurs, meritat ia dedikojnë Rreshter major Sheryl Lion, e cila gjithnjë i ka mbështetur dhe motivuar për kryerjen me sukses të detyrave. Për të mësuar më shumë për bashkëpunimin dhe mbështetjen profesionale të Ekipit të KFOR-it amerikan, biseduam me Rreshter-major Sheryl Lion, e cila me dëshirë pranoi të jap intervistë për gazetën e FSK-së "Forca Jonë". Gjatë intervistës,

Ajo me modesti rezultatet e punës së përgjithshme ia dedikon ekipit amerikan edhe instruktorëve të FSK-së.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është bashkëpunimi i juaj me FSK-në?*

Rreshter major Sheryl Lion: "Kemi një bashkëpunim të mirë me FSK-në, sidomos me Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Ekipi amerikan ka punuar ngushtë me ekipin e FSK-së, dhe kemi arritur që të adoptojmë kursin për pjesëtarët e FSK-së, i cili u zhvillua me sukses në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes. Kursi ka zgjatë 7 javë dhe pas përfundimit të tij janë certifikuar 12 instruktorë të FSK-së, të cilët aktualisht janë duke zhvilluar trajnimin tjetër "Trajno-Trajnerët" dhe "Kursin e Avancuar të Liderit" (KAL)". Jam shumë e kënaqur me bashkëpunimin dhe me ngritjen profesionale të instruktorëve si dhe me arritjet e përgjithshme të FSK-së.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janë arritjet e kandidatëve për instruktorë të FSK-së të cilët ju i keni menaxhuar?*

Rreshter major Sheryl Lion: "Secilin kurs për instruktorë duhet ta filloni prej asaj themelore e të vazhdoni tutje. Ne kemi filluar prej aty ku mund të përfshihen të gjithë pjesëtarët. Kërkesa për këtë kurs është bërë

para dy vitesh. Pasi që FSK-ja ka pranuar këtë kërkesë, atëherë kemi filluar ta ndjekim rrugën nëpërmjet zinxhirit komandues deri te realizimi i kursit. Para se të fillojmë me realizimin e kursit, Ekipi ynë në bashkëpunim me FSK-në kanë bërë përgatitjet e nevojshme. Ne ua kemi ofruar bazën për realizimin e këtij trajnimit, të cilën instruktorët e FSK-së në të ardhmen do ta adaptojnë dhe zhvillojnë për nevojat e tyre. Vlerësimi ynë ka qenë dhe mbetet se FSK-ja ka bërë një përzgjedhje të shkëlqyeshme të kandidatëve për këtë kurs. Shumica prej tyre edhe më parë kanë ndjek disa trajnime jashtë vendit, respektivisht nëpër shkollë

Interesimi për kursin "Trajno-Trajnerët" nga ekipi amerikan ka qenë i madh, po aq i madh ka qenë edhe interesimi i pjesëtarëve-instruktorëve të FSK-së, të cilin po e organizojnë dhe po e realizojnë me sukses në bashkëpunim me ekipin amerikan.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është bashkëpunimi në relacion FSK-Bondstill?*

Rreshter major Sheryl Lion: Pas ardhjes tonë, me rastin e ndërrimit të kontingjentit, na është dashur pak kohë që të fillojmë takimet për vendosjen kontakteve të para. Ato relacione janë ndërtuar vazhdimisht dhe kemi

Kosovë. Më pëlqejnë traditat dhe krenaria e këtij populli. Njerëzit na përshëndesin kudo që takohe mi, kjo më bën të ndihem mirë. Në fillim të misionit tim në FSK, gjatë pjesëmarrjes sime të parë në ceremoninë e certifikimit të nënoficerëve, nga afër kam parë se sa krenar ndihen nënoficerët dhe oficerët e FSK-së për punën dhe profesionalizmin e treguar. Këtë e kam parë edhe në jetën e përditshme, këtu në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, dhe kjo po më pëlqen shumë, vetëm vazhdoni kështu. Me rëndësi për të ardhmen tuaj janë puna dhe shkollimi për arritjen e rezultateve të përgjithshme.

Gazeta "Forca Jonë": *Rreshter major, cili është mesazhi juaj për FSK-në?*

Rreshter major Sheryl Lion: Ju dëshiroj çdo të mirë, fat dhe sukses. E di që për një kohë të shkurtër keni arritje të mëdha, pres që këto të arritje të vazhdojnë tutje, ngase rruga është dhe tani vetëm duhet të ecët përpara. Kjo më bën të ndihem mirë. Të dy kurset, të cilat i kemi përgatitur nga instruktorët dhe nga nënoficerët amerikan, "Lideri Luftarak" dhe "Kursi i Avancuar për Lider", tashmë janë një sukses për të ardhmen, dhe të dy këto kurse po realizohen me sukses në KDS. Dëshira ime është që FSK-ja të arrijn sa më larg në zhvillimin e nënoficerëve.

Në fund, ne u ndamë nga rreshter majori Lion duke i uruar shëndet dhe punë të mbarë në Amerikë, ndërsa instruktorët e FSK-së e falënderuan nga zemra për punën e palodhshme dhe mbështetjen e saj të madhe në arritjen e sukseseve.

Mesazhi: Nënoficerët në SHBA dëshirojnë që vazhdimisht ta zhvillojnë vetveten, kurse nënoficerët e lartë përveç vetvetes kanë obligim të zhvillojnë edhe nënoficerët tjerë. Shpresoj që kur të kthehem pas disa viteve në Kosovë të shoh zhvillimin dhe avancimin profesional edhe më të madh të nënoficerëve të FSK-së.

lat amerikane, dhe kjo na ka ndihmuar gjatë realizimit të kursit për të qenë sa më efikas dhe sa më të suksesshëm. Këta instruktorë vërtetë kanë qenë të shkëlqyeshëm.

Gazeta "Forca Jonë": *Sa janë të gatshëm instruktorët e FSK-së ta zhvillojnë një kurs të tillë në të ardhmen?*

Rreshter major Sheryl LION: Instruktorët e FSK-së janë të gatshëm që të organizojnë dhe realizojnë kurse të tilla, ata tani janë duke mbajtur "Kursin e Avancuar të Liderit", të cilin herë-pas herë e menaxhojmë edhe nga afër.

bashkëpunuar me të gjitha palët, si: NLAT, ODC (Zyra për Bashkëpunim Zhvillimor), KFOR-in, me qëllim që ta ndihmojmë FSK-në, dhe kjo është shpërblyer sepse ne po i shohim rezultatet e FSK-së çdo ditë. Shumica e trajnimeve po realizohen këtu, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj.

Gazeta "Forca Jonë": *Jeni në përfundim të misionit tuaj në Kosovë, cili është mendimi juaj në përgjithësi për Kosovën dhe FSK-në?*

Rreshter major Sheryl Lion: Populli është shumë miqësor në



Intervistë me Major Ejup Maqedoncin, shef i Logjistikës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së

Major Ejup Maqedonci merr titullin "Master i Shkencave dhe Arteve Ushtarake", në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së SHBA-ve

Oficerët e FSK-së vazhdojnë të tregohen të suksesshëm në trajnime edhe në shkollime jashtë vendit, madje ata kthehen edhe me medalje nderi të vendeve përkatëse, ku i përfundojnë shkollimet ose trajnimet në lëmi të ndryshme. Oficeri i radhës i FSK-së, që tregoi performancë të shkëlqyeshme gjatë shkollimit të tij, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) shpallet edhe "qytetar nderi i qytetit të Leavenworthit".

Majori i FSK-së, shef i Logjistikës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC-së), Ejup Maqedonci është edhe një tjetër oficer i FSK-së që kthehet me titull akademik dhe mirënjohje nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA-të). Gjatë shkollimit në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (US Army Command and General Staff College - Fort Leavenworth) prej 24 tetor 2012 deri më 13 dhjetor 2013, tregoi një performancë të shkëlqyer në mesin e shumë oficerëve amerikanë si dhe oficerëve të shteteve tjera, kjo dëshmohet edhe me vlerësimin akademik të bërë nga Kolegji CGSC, që është vlerësuar me notën më të lartë 1 (1 më e larta dhe 6 më e ulëta) si dhe në përgjithësi sa i përket notave të provimeve në vlerësimet e bëra nga instruktorët dominon nota A e që është ekuivalente me notën 10 në universitetet e Kosovës. "Shkollimi në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së SHBA-ve ishte një eksperiencë e veçantë për mua. Atje përpos njohurive të reja të aspektit të strategjisë, operacioneve dhe taktikës ushtarake kam fituar dhe njohuri të reja rreth kul-

turave të ndryshme, e në veçanti rreth kulturës dhe vlerave amerikane. Gjatë gjithë kohës së qëndrimit tim atje jam ndier krenar që përfaqësoja Kosovën në njërin nga institucionet më të vlerësuara edukative ushtarake në Botë, siç është CGSC. I vetëdijshëm për nevojën që ka FSK-ja për ngritjen dhe zhvillimin profesional, besoj dhe do të angazhohem që njohuritë e fituara atje ti vej në shërbim të FSK-së dhe vendit tim", tha major Maqedonci. Gjatë kësaj periudhe, ai ka përfunduar trajnimet për Kursin e Gjuhës Profesionale Ushtarake Angleze, në Institutin e Gjuhëve të Huaja (DLI) San Antonio, Texas, SHBA: Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Fort Leavenworth, Kansas, SHBA. Po ashtu ai ka bërë edhe shkollim shtesë në fushën e shkencave dhe arteve ushtarake në kuadër të së cilave ka përfunduar dhe tezën e masterit me titull: "Mbështetja e Kosovës për Operacionet e NATO-s", ku ka fituar titullin "Master i Shkencave dhe Arteve Ushtarake" (Msc dhe MA). Qëllimi i shkollimit në SHBA ishte përfitimi i njohurive të



përgjithshme ushtarake në aspektin e komandimit, planifikimit dhe organizimit, ku u përfshinë lëndët dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me: Strategjinë ushtarake, Operacionet, Taktikën, Lidërshpin, Historinë ushtarake, Mbështetjen, Etikën ushtarake, Mendimin kritik, Studimet regjionale evropiane, Procesi i marrjes së vendimeve ushtarake, Ushtrimet në vendkomandë etj. Ejup Maqedonci gjatë karrierës së tij prej ushtaraku që nga koha e UÇK-së, me pas TMK-së dhe tani në FSK, ka pasur disa detyra dhe funksione të ndryshme, si: Shef i Sektorit të Mbështetjes Logjistike të Regjimentit të Mbrojtjes Civile; Komandant i Kompanisë së Kërkim-Shpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së); Komandant i Kontingjentit të FSK-së gjatë përmbajtjeve në Shkodër,

Republika e Shqipërisë; Komandant i Batalionit të Kërkim-Shpëtimit të Brigadës së Mbrojtjes Civile (TMK); Komandant i Batalionit të Parë të Brigadës 153 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka përfunduar disa trajnime të rëndësishme edhe në fusha të ndryshme, ku edhe merr tituj të rëndësishëm ushtarak, si: Instruktor i Topografisë dhe përdorimit të sigurt të armëve, KDS, në Prishtinë (Inst. Britanik); Instruktor i Repelimit; Instruktor i Kërkim-Shpëtimit Urban; Këshilltar Ndërkombëtar i Kërkimit Luftarak (Qendra Ushtarake në Chatham-Britani e Madhe), Instruktor i përgjithshëm i kërkim-shpëtimit dhe menaxhimit të emergjencave-kurs tremujor (i realizuar në qytetin e Japonisë OSAKA), i certifikuar në nivelin e parë të zhytjes, në Kosovë (Federata e Zhytjes); Qytetar nderi i Leavenworthit (SHBA). Gjatë periudhës 15 vjeçare si ushtarak, Ejup Maqedonci ka marr shumë mirënjohje nga krerë të lartë të shteteve duke filluar nga Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë, Mbretëria e Japonisë, SHBA-të etj. Medalja për Shërbim Ushtarak nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë (08.07.2011); Medalja për Shërbime të Shquara nga Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë (16.02.2010); Medalja e Shërbimit në TMK, nga Komandanti i TMK-së (2008); Dekoratën "Zahir Pajaziti" të UÇK-së (28 Nëntor 2000) nga Komandanti i ZOLL-it; Mirënjohje nga Ministri i FSK-së, për ndihmën e dhënë gjatë përmbajtjeve në Shkodër, (2010); Mirënjohje nga Komandanti i FSK-së, për ndihmën e dhënë gjatë përmbajtjeve në Shkodër (2010);

Mirënjohje nga Prefekti i Prefekturës Shkodër, Janar 2010; Mirënjohje për profesionalizmin e treguar në TMK, nga Komandanti i Zonës së Pestë Mbrojtëse; Mirënjohje për kontributi në UÇK nga OVL e UÇK-së. Major Ejup Maqedonci ka lindur në Prishtinë më 09.05.1977. Gjatë luftës në Kosovë (1998-1999) ishte Komandant i Batalionit të Parë të UÇK-së në Brigadën 153 të Z.O.L.L. Nga viti 2006 deri më 2009 ka përfunduar studimet Baçellor në Kolegjin "Pjeter Budi", në Prishtinë, në drejtimin e Doganës dhe Shpeditonit. Gjatë kohës së shërbimit në TMK, ka udhëhequr Batalionin e Kërkim-Shpëtimit dhe gjatë kësaj periudhe ka udhëhequr shumë operacione si dhe ka marrë pjesë në shumë trajnime të organizuara nga forcat e NATO-s dhe institucionet tjera në Kosovë. Me krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës është emëruar në detyrën e Komandantit të Kompanisë së Kërkim-Shpëtimit. Gjatë kohës sa ka shërbyer në këtë detyrë ka ndjekur trajnime specialiste për kërkim-shpëtim në Britani të Madhe dhe Japoni. Në vitin 2010 dy herë është caktuar si Komandant i Kontingjentit të FSK-së në Republikën e Shqipërisë, gjatë operacionit humanitar dhe të shpëtimit në Shkodër. Në vitin 2011 është avancuar në gradën Major, si Shef i Logjistikës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile. Në vitin 2012-2013, ka ndjekur studimet në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Fort Leavenworth, ku përpos diplomimit në Kolegji, ka përfunduar dhe studimet e shkallës Master dhe ka fituar titullin "Master i Shkencave dhe Arteve Ushtarake".



Kompania e Mjekësisë në shërbim të gjithë pjesëtarëve të FSK-së edhe qytetarëve të Kosovës



Shkruan: Nënkolonel dr. Hamide OSAJ

Kompania e Mjekësisë gjatë vitit që lamë pas ka realizuar të gjitha detyrat me përgjegjësi të madhe. Ekipet mjekësore të saj, ju ofrojnë asistencë mjekësore në shumë fshatra të banuara kryesisht me pjesëtarë të komuniteteve, gjithashtu së bashku me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, brenda vitit organizon dhurimin vullnetar të gjakut në kazernat e FSK-së, ku nga pjesëtarët e FSK-së për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë, dhurohet vullnetarisht mbi 1000 doza gjak, etj.

Struktura e Kompanisë së Mjekësisë përbëhet prej grupit komandues, ekipit të mjekimit, tri ekipeve të evakuimit, ekipit të farmacisë, si dhe sektorit civil, që përbëhet nga shërbimi i stomatologjisë, mjekësisë preventive (e paplotësuar) dhe veterinarisë (e paplotësuar). Kompania e Mjekësisë është përgjegjëse për ndihmë mjekësore mobile dhe evakuim mjekësor nga terreni deri në spitalet civile si mbështetje e një-sive të FSK-së. Gjithashtu, KM e mbështet FSK-në me shqyrtime mjekësore, këshilla profesionale për stafin dhe stërvitjen mjekësore. Sipas urdhrat, ofron mbështetje mjekësore për autoritetet civile në Kosovë, si dhe merr pjesë në operacionet e përbashkëta jashtë vendit.

Kompania e Mjekësisë çdo ditë ofron shërbime ambulatorie të mjekësisë së përgjithshme dhe stomatologjike, intervenime mjekësore (injeksione, infuzione, pastrim plagësh, etj), evakuime mjekësore me autoambulanca, mbështetje mjekësore për njësitë tjera të FSK-së dhe autoritetet civile, varësisht nga urdhrat.

Kompania e Mjekësisë kryen shër-

bime mjekësore nga mjekësia e përgjithshme, si dhe i plotëson të gjitha kërkesat nga stomatologjia. Në bazë të misionit, Kompania e Mjekësisë i mbulon të gjitha nevojat për shërbime mjekësore për pjesëtarët e FSK-së. Njësitë e FSK-së janë të dislokuara në disa qytete të Kosovës me personel mjekësor të sistemuar në këto lokacione. Në çdo kazermë të FSK-së ka shërbime mjekësore si, në: Batalionin e Parë të BRSH-së në Gjiilan, Batalionin e Dytë të BRSH-së në Istog, Batalionin e Tretë në Mitrovicë, në RMC - Pomozetin, në Kompaninë e Deminimit në Prizren, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Kompania e Mjekësisë i mbështet të gjitha ushtrimet fushore në nivel vendi dhe merr pjesë aktivisht në to, por gjithashtu në vitin 2013 KM ka

Gjatë vitit kemi ofruar mbështetje mjekësore, Ministrisë së Diasporës, Shoqatës së Çiklizmit, Shoqatës së Diabetikëve, transferimin e pacienteve në QSU-Tiranë, etj.

Momentalisht ekipet mjekësore të Batalionit të Dytë janë duke ofruar asistencë mjekësore në fshatrat e banuara kryesisht me pjesëtarë të komuniteteve, si në Komunën e Burimit, etj.

FSK-ja së bashku me QKTGJK, brenda vitit, dy herë (qershor dhe dhjetor), organizon dhurimin vullnetar të gjakut në kazernat e FSK-së, ku dhurohet mbi 1000 doza gjak, për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë. Staf i Kompanisë së Mjekësisë në vitin 2013, është dalluar për kryerjen e të gjitha detyrave dhe trajnimeve



marr pjesë edhe në ushtrimin fushor që është mbajtur në Republikën e Maqedonisë (nën organizim të EUCOM), ku kanë marrë pjesë 7 shtete të ndryshme.

Kompania e Mjekësisë ka pajisje të mjaftueshme për shërbime mjekësore në terren.

Kompania e Mjekësisë ka bashkëpunim të mirë me QKUK-në dhe spitalet në nivel vendi si dhe me IKSHPK (çdo vit na furnizon me vakcina kundër gripit sezonal) dhe QKTGJK.

Shërbimi mjekësor i FSK-së është gjithmonë i gatshëm të ndihmojë autoritetet civile me të gjitha kapacitetet e veta që ka në dispozicion sa herë që paraqitet nevoja.

mjekësore në Gjermani, certifikimin e një instruktore për gjuhë angleze në SHBA, një pjesëtar i KM-së është certifikuar nga KFOR-i amerikan për instruktur të trajnimit: Personi i Parë në Vendngjarje, shkëmbim përvojash mjekësore me EUCOM-in, Spitalin Ushtarak në Hamburg të Gjermanisë, etj. Bordi mjekësor ka realizuar shqyrtimet mjekësore vjetore për personelin e FSK-së, por ajo që e dallon Kompaninë e Mjekësisë është suksesi i jashtëzakonshëm i arritur në ushtrimin fushor në Republikën e Maqedonisë (ku kanë marrë pjesë shtatë shtete: Shqipëria, SHBA, Bosnja, Maqedonia, Sllovenia, Mali i Zi dhe Kosova.



FSK-ja në Kampionatin Regjional të Atletikës Ushtarake në Llozanë të Zvicrës

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) në kuadër të bashkëpunimit me Komitetin Ndërkombëtar të Sporteve Ushtarake për Evropë (CISME), nga data 17-19 janar 2014 mori pjesë në Kampionatin Regjional të Atletikës, "Cross Country Sport", që u mbajt në qytetin e Llozanës -Zvicër, ku për herë të parë nga Ushtria Zvicerane si nikoqir i garave është ftuar edhe një ekip i FSK-së.

Në këtë kampionat ishin pjesëmarrës 13 delegacione dhe ekipe ushtarake nga shtetet që bëjnë pjesë në grupin prestigjioz të vendeve që e përbëjnë Grupin Regjional Nordik-Beneluks të CISM-it, si dhe disa ekipe mysafir, si ekipet ushtarake nga: Zvicra, Gjermania, Belgjika, Holanda, Franca etj.

Delegacioni i FSK-së përbehej nga tetë pjesëtarë, ku në kuadër të ekipit garues ishin katër ushtarë dhe dy ushtarë, të cilët garuan në dy disiplina: vrapim në shtigje të shkurta dhe shtigje

të gjata. Në vrapimin e shtigjeve të gjata morën pjesë dy ushtarë dhe dy ushtarë të FSK-së. Gara ishte shumë e fortë, edhe pse pjesëtarëve të FSK-së u mungonte përvoja arritën të dallohen me përkushtimin, angazhimin dhe disiplinën e treguar gjatë këtij kampionati. Pjesëmarrja e ekipeve të FSK-së është vlerësuar lartë nga delegacionet ushtarake të vendeve të lartpërmendura, dhe ato gjithashtu kanë shprehur gatishmërinë e tyre që ta ftojnë FSK-në në aktivitetet që do të mbahen në vendet e tyre. Udhëheqësi i delegacionit të FSK-së, nënkolonel Fadil Hoxha, pas kthimit ka thënë: "Në Llozanë jemi pritur dhe trajtuar shumë mirë nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, ne kemi garuar me të gjitha ekipet ushtarake pjesëmarrëse si: Zvicra, Gjermania, Belgjika, Holanda dhe Franca. Garat ishin shumë të forta dhe pjesëtarët tanë janë vlerësuar lartë nga delegacionet ushtarake", shtoi në fund nënkolonel Hoxha.



Me nderime varrosët Blerim Krasniqi, tetar i FSK-së

Më 1 janar 2014, në varrezat e fshatit Tërpezë të Malishevës, me nderime të larta u varros tetar Blerim Skënder Krasniqi pjesëtar i FSK-së, me detyrë në Qendrën e Studimeve Universitare (Shkollën Ushtarake të FSK-së) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Blerim Krasniqi u lind më 02. 03. 1978 në fshatin Tërpezë, Komuna e Malishevës. Blerimi mësimet e para i kreu në shkollën fillore të fshatit të tij të lindjes, ku dallohet në mësimet dhe në shkathtësitë e tij në aktivitetet të lira. Shkollën e mesme e kreu në fshatin Kijevë të Malishevës. Qysh në moshën e re, Blerimi së bashku

me babanë e tij Skënderin, iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Brigadën 121 "Kumanova".

Pas përfundimit të luftës, Blerimi u sistemua në Gardën e Kosovës të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Më 2009, me krijimin e FSK-së, Blerimi ka punuar në Qendrën për Studime Universitare (Shkollën Ushtarake të FSK-së) të Forcës së Sigurisë të Kosovës, e cila vepron në kuadër të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS). Ai gjatë kësaj kohe, dallohet me angazhimin maksimal edhe në arritjen e rezultateve të shkëlqyeshme. Më 31 dhjetor, pas një sulmi kardiak, Blerimi u nda nga



jeta në moshë të re, kur më së shumti i duhej familjes së tij dhe FSK-së. Blerimi ishte i martuar dhe i pas gruan dhe dy djem.

Ceremonia e varrimit u bë me përcjellje të Togut Ceremonial të FSK-së. Para qytetarëve të shumtë, që kishin ardhur për të dhënë lamtumirën e fundit Blerim Krasniqi, fjalën mortore në emër të FSK-së e mbajti komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili foli për punën, profesionalizmin dhe angazhimin e pakursyer të tij në FSK. Më pastaj foli përfaqësuesi i Shoqatës së Veteranëve të Komunitetit të Malishevës, i cili rikujtojë pjesëmarrjen e Blerimit në moshë fare të re në radhët e UÇK-së, më pas ai foli për punën e tij në TMK dhe si pjesëtar i FSK-së. Në emër të familjes nga familjaret e tij

u falënderuan të gjithë pjesëmarrësit që gjetën kohë për të bërë nderimet e fundit Blerimit dhe për të ndarë dhimbjen me ta.

Për të përcjellë Blerim Krasniqin për në banesën e fundit kishin ardhur; zëvendësministri Muhamed Latifi e Bejtush Gashi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i Komandës së Forcës Tokësore (KFT-së) gjeneralmajor Rahman Rama, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi, oficerë të lartë, nënoficerë dhe ushtarë të FSK-së, veteranë të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të shumtë.